

# Forumi shumaktorial mbi parandalimin e pastrimit të parave

PËRMBLEDHJE | 13 PRILL 2022

*Forumi mblodhi së bashku në tryezë përfaqësues të shoqërisë civile, medias investigative, rretheve akademike, shoqatave të sektorit privat, institucionet publike, politikbërës dhe partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta të luftës ndaj pastrimit të parave në Shqipëri. Forumi synoi të kontribuojë në rolin, vizibilitetin dhe ndikimin më të madh të aktorëve joshitetërorë në politikat e parandalimit të pastrimit të parave.*

*Forumi shumaktorial u zhvillua në kuadër të programit “Mbështetja e Luftës ndaj Pastrimit të Parave në Shqipëri”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Dhomën Amerikane të Avokatisë, me mbështetjen e Departamentit të Shtetit të Sh.B.A.*

## Përfundimet kryesore:

- Regjimet efektive ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kërkojnë një qasje ndërdisiplinare dhe përfshirjen e plotë të aktorëve joshitetërorë;
- Parandalimi i pastrimit të parave kërkon bashkëpunimin e të gjitha palëve në të gjitha nivelet, përfshirë në nivelin ndërkombëtar.
- Nevojitet përditësimi i kurrikulave në fakultetet kryesore dhe bashkëpunim i shtuar i akademisë me shoqërinë civile për organizimin e konferencave akademike për të prezantuar punimet e studuesve dhe për ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të nevojshme në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;
- Organizatat mediatike kanë një rol të rëndësishëm në hetimin e rasteve të pastrimit të parave, kryesisht të rasteve që lidhen me korrupsionin e lartë apo krimin e organizuar. Për këtë qëllim,

duhet bashkëpunim i shtuar me aktorë të tjerë, përfshirë shoqërinë civile apo sektorin privat, për të ngritur kapacitetet e nevojshme për hulumtim.

## Përmbledhje e diskutimeve

Gjatë fjalës hyrëse, Drejtori Ekzekutiv i IDM, Sotiraq Hroni, theksoi se IDM synon të sjellë një vëmendje të shtuar mbi çështjet e pastrimit të parave dhe të nxisë aktorët joshtetërorë që të fokusohen sistematikisht në proceset dhe sfidat e parandalimit të pastrimit të parave. Bashkëpunimi i aktorëve joshtetërorë për të adresuar nevojat reciproke, për t'iu qasur së bashku sfidave dhe për të mbështetur institucionet publike me burime të reja njohurish përbëjnë një komponent të munguar deri më tani. Z. Hroni shpjegoi se qëllimi i forumit është pikërisht vendosja e një praktike të qëndrueshme konsultimi mes institucioneve përgjegjëse dhe palëve të interesuara.

**Sotiraq Hroni**  
**Drejtor Ekzekutiv,**  
**IDM**

Adea Pirdeni, Zv. Ministre e Drejtësisë, u shpreh se prioriteti i Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të ICRG/FATF është përforcimi i kontrollit të profesioneve të caktuara jofinanciare (DNFBPs). Në këtë kuadër, është bërë punë intensive për të përmirësuar kornizën ligjore për të shmangur lidhjet potenciale të krimit të

organizuar me profesionet e lira. Përgjatë vitit 2021, janë hartuar dhe miratuar dy akte ligjore të rëndësishme që rregullojnë profesionin e noterisë dhe të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme. Znj. Pirdeni vlerësoi bashkëpunimin e palëve të interesuara në procesin e hartimit të akteve ligjore. Në përfundim të fjalës së saj, Znj. Pirdeni theksoi nevojën e domosdoshme për të zhvilluar periodikisht tryeza konsultimi për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi masat e marra për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të patur një bashkërendim të shtuar të punës me aktorët joshtetërorë dhe partnerët ndërkombëtarë.

**Adea Pirdeni**  
**Zv. Ministre e Drejtësisë**

Përfaqësuesi i Ambasadës së Sh.B.A në Tiranë, Benjamin Rockwell, u shpreh se Shqipëria po bën progres të qënësishëm në reformën në drejtësi dhe luftën ndaj korrupsionit por prania e Shqipërisë në listë gri të FATF-së është një problem mbarëshoqëror me ndikim të thellë. Qeveria e Sh.B.A-së po mbështet Ministrinë e Drejtësisë në përmirësimin e mbikëqyrjes së sektorëve të noterëve dhe ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme nëpërmjet një partneriteti me Dhomën Amerikane të Avokatisë. Ky partneritet përfshin punën e IDM-së për të angazhuar shoqërinë civile në çështjet e parandalimit të pastrimit të parave. Z. Rockwell theksoi se trajtimi efektiv i këtij problemi do të kërkojë përfshirjen aktive të shoqërisë civile, qofshin gazetarët

investigativ që hetojnë lidhjen e pastrimit të parave dhe korrupsionit, akademikët dhe OShC-të që këshillojnë për ndryshimet e nevojshme legislative, apo shoqatat e sektorit privat që tregojnë si të funksionojë sistemi për të rregulluar problemet dhe për të nxitur rritjen.

**Benjamin Rockwell**  
**Ambasada e Shteteve të**  
**Bashkuara në Tiranë**

Përfaqësuesi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Aurélien Juliard kujtoi se parandalimi i pastrimit të parave është një sfidë për të gjitha shtetet. Seksioni i sundimit të ligjit në progres-raportin e fundit të Komisionit Evropian përmban shumë detaje për regjimin e parandalimit të pastrimit të parave. Z. Juliard u shpreh se Bashkimi Evropian ka mbështetur institucionet në procesin e harmonizimit me *acquis* të BE-së por nevojitet më tepër zbatim dhe pajtueshmëri me kornizën ligjore. Për këtë, duhet të rriten kapacitetet e prokurorëve të rretheve për të hetuar pastrimin e parave, meqë kjo vepër është në fushëveprimin e tyre. Në këtë aspekt, BE po mbështet nëpërmjet projektit EU4FOCAL.

**Aurélien Juliard**  
**Delegacioni i BE në Shqipëri**

Paneli i diskutimit, i moderuar nga Gjergji Vurmo, Drejtor Programi pranë IDM, ofroi këndvështrimet e aktorëve të

ndryshëm mbi sfidat dhe prioritetet përse i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe rolit të shoqërisë civile, akademisë dhe medias në përpjekjet për përmirësimin e regjimit.

Ardita Shehaj, këshilltare pranë GIZ Albania, theksoi se përvojat ndërkombëtare tregojnë se regjimet efektive ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kërkojnë përfshirjen e plotë të shoqërisë civile. Znj. Shehaj u shpreh se pavarësisht se rekomandimi nr. 8 i FATF (*mbi sektorin e OJF-ve*) flet për mjaftueshmërinë e rregullave dhe ligjeve dhe plotësimin e kornizës rregullatore, nevojitet të ketë një masë të lartë të zbatimit të ligjeve. Znj. Shehaj theksoi se *think tanks* dhe gazetarët janë gjithashtu *target group* i rëndësishëm. Duke patur parasysh se po shkojmë drejt një ekonomie globale, është i rëndësishëm hetimi në rang rajoni nga ana e gazetarëve. Por Znj. Shehaj u shpreh se fakti se kategori të dhënash që duhet të ishin publike nuk janë pjesë e regjistrimit të përfituesve përbën pengesë për hetimin e rasteve.

**Ardita Shehaj**  
**GIZ Albania**

Fabian Zhilla, studiues pranë Nismës Globale kundër Krimin të Organizuar Transnacional, argumentoi se, përtej kornizës ligjore, duhet punuar me ndërhyrje të buta për të përmirësuar efikasitetin. U shtruan sugjerime për rrethet akademike të tilla si përditësimi i

kurrikulave në Fakultetin e Drejtësisë, Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Inxhinierisë dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për organizimin e konferencave akademike tematike për të prezantuar punimet e studiuesve. Nevojitet përfshirja e shumë disiplinave për shkak se skemat e pastrimit të parave bëhen gjithnjë e të sofistikuara. Për rrjedhojë, direktivat e BE-së po shtyjnë drejt parandalimit nëpërmjet instrumenteve administrative, jo penale. Z. Zhilla theksoi se në bisedë duhet të përfshihen dhe dhomat e biznesit pasi vetë biznesi është i shqetësuar për shtrembërimin që pëson tregu si pasojë e volumeve të larta të pastrimit të parave. Në përfundim të fjalës së tij, Z. Zhilla nënvizoi vështirësinë e hetimit nga shoqëria civile apo media për shkak të kufizimit të aksesit në të dhëna dhe platformave të të dhënave të institucioneve të cilat e bëjnë hulumtimin e pamundur.

**Fabian Zhilla**  
*Global Initiative against  
Transnational Organized Crime*

Kristina Voko, Drejtore Ekzekutive e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative, shpjegoi se diskutimi nuk duhet limituar vetëm për gazetarinë investigative por duhet zgjeruar pasi shumë hetime kryhen në bashkëpunim të ngushtë me gazetarë të fushave të tjera, për shëmbull, gazetarë të ekonomisë. Znj. Voko theksoi se qëllimi dhe funksioni i gazetarisë është të nxjerrë në dritë informacione të

panjohura për publikun. Por kufizimi i aksesit në gjykata dhe të vendimeve gjyqësore pengon punën e medias. Znj. Voko gjithashtu theksoi se ka një mungesë të madhe të të dhënave statistikore përse i përket luftës ndaj pastrimit të parave, sidomos të dhënat që lidhen me krimin e organizuar. Znj. Voko përfundoi fjalën e saj duke sjellë në vëmendje reflektimin e pakët të çështjeve të pastrimit të parave në media.

**Kristina Voko**  
*BIRN Albania*

Diskutimet e panelit u ndoqën nga komente nga grupet kryesore të interesit: Dhoma Kombëtare e Noterisë; Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë (NAREA); dhe përfaqësues të profesioneve të lira (auditues ligjor/kontabilistë).

Përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Z. Fatmir Laçe, u shpreh se ndërgjegjësimi i noterëve ka ardhur gjithnjë në rritje, çka reflektohet edhe në numrin e raportimeve nga noterët për raste të dyshimta të pastrimit të parave. Tanimë çdo zyrë noteriale ka një rregullore dhe një regjistër të posaçëm për parandalimin e pastrimit të parave.

Përfaqësuesit e NAREA, Z. Reinaldo Pipiria dhe Znj. Ilda Zaloshnja, theksuan rëndësinë e përfshirjes së sektorit të ndërmjetësimit të pasurive të

paluajtshme, pavarësisht se janë aktor relativisht i ri. Z. Pipiria u shpreh se NAREA ka ngritur shqetësimet e saj me Ministrinë e Drejtësisë dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë në vijim për miratimin e akteve nënligjore, pjesë e ligjit të ri që rregullon profesionin e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme.

Z. Hysen Çela, profesor pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, u shpreh se, përsa i përket profesionit kontabël, ky sektor ka organizmat vetërregullatore dhe instrumentet mbikëqyrëse që duhet të përshkallëzojnë bashkëpunimin. Gjithashtu, vlerësoi ndërtimin e praktikave të mira nëpërmjet ekspertizës më të lartë ndërkombëtare.

Përfaqësuesja e FIIAPP (*International and Ibero-American Foundation for Administration and Public Policies*), e cila është angazhuar në projektin EU4FOCAL, u shpreh se duhet ndjekur paraja dhe pasuria e krimit të organizuar, përtej përpjekjeve të parandalimit dhe ndërgjegjësimit. Zbatimi i kornizës ligjore penale duhet përforcuar. Znj. Garcia Iglesias theksoi se kjo çështje kërkon bashkëpunimin e të gjitha palëve në të gjitha nivelet, përfshirë në nivelin ndërkombëtar. Në përfundim të fjalës, u nënvizua se duhen përshkallëzuar përpjekjet për të përshpejtuar nismat e bashkëpunimit ndërkombëtar në mënyrë që prokurorët të vihen në kontakt me njëri tjetrin drejtpërdrejtë, jo nëpërmjet një autoriteti qendror.



The Institute for Democracy and Mediation – IDM was established in November 1999 as a non-governmental organization, dedicated to consolidating participatory governance and democratic institutions, EU integration processes, civil society development, regional cooperation and security affairs through independent research, capacity building and engagement of societal players.

